

Prof.asoc.dr. Gentiana Skura*

Dr. Zylyftar Bregu^Y

Roli i operatorëve kabllorë në panoramën e transmetimeve televizive në Shqipëri

Artikulli synon të analizojë rolin, shtrirjen, shërbimet dhe arsyet e gjallimit të shërbimit televiziv kabllor në Shqipëri. Për këtë artikull janë përdorur metodat empirike si dhe metoda sasiore e cilësore; janë shfrytëzuar korpusi i materialeve dokumentare, të siguruara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), raporte dhe dokumenta të operatorëve të ndryshëm kabllorë, si dhe organizata që përfaqësojnë këta operatorë; së dyti bazuar në intervistat e realizuara me një numër të madh të administratorëve të operatorëve kabllorë. Janë zhvilluar më shumë se dhjetë takime dhe biseda me këta administratorë; së treti nëpërmjet bisedave me klientë/konsumatorë të këtij produkti.

Operatorët e shërbimit televiziv kabllor në Shqipëri kanë njohur një zhvillim të jashtëzakonshëm në Shqipëri pas vitit 2004. Kjo ka shpjegimin dhe kontekstin e vet, pasi a) lidhet me zhvillimin, konsolidimin përpjestimin e tregut televiziv në Shqipëri; b) lidhet me konceptimin e tregut televiziv kryesisht me një treg ekonomiko-financiar dhe më pas misionar; c) lidhet me infrastrukturën teknologjike të përdorur.

Të tria këto rrethana do të përpiqemi t'i argumentojmë më poshtë.

* Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës,
Email: gentaskura@gmail.com

^Y Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës,
Email: breguz@gmail.com

Sipas statistikave zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive në Republikën e Shqipërisë janë licensuar 115 Operatorë të Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA, emërtimi ligjor) që ofrojnë përsëritjen e sinjalit televiziv nëpërmjet kabllit. Ose ndryshe, operatorë televizivë, pra që nuk prodhojnë kontent të tyre, thjesht r-transmetojnë kontentin e operatorëve të tjerë, vendas apo të huaj.

Por, nga vëzhgimet në terren një numër tjetër OSHMA-sh, që shkojnë të paktën deri në 10 për qind të shifrës së operatorëve të licensuar, funksionojnë në mënyrë pirate, pa autorizimin përkatës, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky numër i operatorëve pa licensë, ndahet në dy kategori - operatorëve, të cilët AMA u ka hequr licensën, por ata vijojnë të ofrojnë shërbimin e tyre. Së dyti, operatorë nëpër territorë shumë të vegjël dhe të largët, të lënë jashtë vëmendjes së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Përshembull vetëm gjatë vitit 2014, janë konstatuar 25 operatorë kabllorë që ofronin shërbim edhe pse nuk kanë qenë të pajisur me licensë nga AMA.

Gjykuar nga harta gjeografike e shtrirjes së operatorëve kabllorë konstatohet lehtësisht se ky shërbim ka lulëzuar kryesisht në zonat rurale të vendit. Në aspektin statistikor, më shumë se gjysma e operatorëve të licensuar ofrojnë shërbimin nëpër njësitë administrative (Komuna); numërohen plot 60 OSHMA, që ofrojnë shërbime në komuna, madje 3-4 OSHMA shtrihen vetëm në territorin e një fshati.

Edhe pjesa tjetër e OSHMA që ofrojnë shërbimin e tyre në zonat urbane kanë një specifikë të përbashkët. Janë kryesisht zonat urbane (qytetet ose qytezat) e skajit të territorit të Shqipërisë.

Vetëm operatori ABCom ka një shtrirje në të gjithë Shqipërinë.

Kjo ka ndodhur për disa arsye, që e bëjnë këtë treg në Shqipëri, të dallojë nga tregjet e tilla në rajon e më gjerë.

Arsyeja e parë lidhet me mungesën thuajse totale të sinjalit të tre kanaleve kombëtare në territorin e vendit, ose në rastin më të mirë, praninë e sinjalit shumë të dobët të Televizionit Publik Shqiptar. Sipas raportit vjetor të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2012 — kombinimi i mbulimeve të realizuar nga transmetuesit, që emetojnë sinjal në VHF, transmetuesit e rrjetit primat në UHF dhe përsëritësve, bëjnë që mbulimi me sinjalin e RTSH të territorit të Republikës të arrijë në mbi 87 %. Problem

kryesor mbetet bashkërendimi i punës me organet e pushtetit lokal për mirëmbajtjen e përsëritësve (mungesë godinash, linjash elektrike dhe pagesa kujdestarësh)” . Ndërsa dy operatorët privatë që kanë licensë kombëtare (Klan Tv dhe Top Channel Tv) transmetojnë në një zonë më të ngushtë, përkatësisht; Operatori kombëtar TV Klan mbulon 78 % të territorit të Republikës së Shqipërisë me sinjal të vazhdueshëm e me cilësi. TCH mbulon 79 % të territorit të Republikës së Shqipërisë. Për shkak të periudhës kalimtare, të transmetimeve nga sistemi analog në atë dixhital, asnjë prej operatorëve kombëtare nuk ka investuar për të rritur përqindjen e mbulimit me sinjal. Përkundrazi, të dhënat operative, jo zyrtare tregojnë se ka pasur ulje të kësaj përqindjeje.

Në këto rrethana televizionet kabllorë kanë lindur si nevojë që zonat e ndryshme në vend kanë nevojë për t’u informuar e mbuluar me sinjal televiziv edhe pse anëtarët e këtyre komuniteteve paguajnë për një shërbim që operatorët televizivë kombëtare kanë detyrimin që t’ua ofrojnë falas.

Arsyeja e dytë lidhet me faktin se bashkë me tre kanalet kombëtare (që edhe nëse do të arriheshin nëpërmjet antenës së thjeshtë analoge duket se janë të pamjaftueshme) këta operatorë kabllorë shtojnë në ofertën e tyre si dhe garantojnë sinjalin edhe të disa dhjetra kanaleve të tjera, të cilat janë televizione lokalë vendas, ose televizione të huaja, italiane, greke, apo televizione ndërkombëtare si BBC, CNN, Al Jazeera, etj. Megjithatë referuar statistikave edhe në BE marrja e shërbimeve televizive nëpërmjet rrjeteve kabllore është në një shifër domethënëse prej 30%.

Tabela1

Në BE marrja e shërbimeve audiovizive bëhet:

Nëpërmjet rrjeteve tokësore të transmetimit audioviziv	(43%)
Nëpërmjet rrjeteve kabllore TV	(30%)
Nëpërmjet satelitit	(25%)
Nëpërmjet IPTV	(7%)
Nëpërmjet Internetit	(4%).

Arsyeja e tretë lidhet me çmimin e përballueshëm të këtij shërbimi si dhe me lehtësirat apo konsensusin në kryerjen e pagesave për këtë shërbim. Siç parashtruam më sipër, ky shërbim ofrohet në zonën rurale, ose edhe në qytezat skajore, banorët e të cilëve kanë të ardhura minimale ekonomike familjare. Sipas intervistave që kemi

kryer, çmimet për —plotën” që ofrohet nga operatorët kabllorë shkojnë 500-600-700 lekë në muaj. Pra, një shumë realitivist e përballueshme për këto familje. Nga ana tjetër, ndryshe nga operatorët dixhitalë kombëtarë, pagesa për operatorët kabllorë mund të kryhet çdo muaj. Së fundi, për shkak se administratorët e këtyre operatorëve, në shumicën e rasteve, janë bashkëvendas me klientët, këta të fundit kanë komoditetin për të paguar edhe pasi kanë konsumuar shërbimin kabllor. Sipas një sondazhi të kryer nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës (2016), të realizuar për shërbimin kabllor, 43 % e të pyeturve, ndër arsyet se përse parapëlqenin shërbimin kabllor janë përgjigjur se është shërbimi më i lirë.

Për shkak të frikës që kanë nga detyrime në tatime, por edhe tek AMA, operatorët kabllorë në shumicën e rasteve nuk tregojnë numrin e plotë të abonentëve të tyre, në mënyrë që të mund të llogaritej numri i saktë i klientëve të kabllorëve. Por, mendohet që janë rreth 200 mijë familje në gjithë vendin që përfitojnë nga ky shërbim. Vetëm operatori kabllor —Abom”, në një nga dokumentat e tij deklaroi se ka 23 mijë abonentë në të gjithë Shqipërinë.

Oferta e televizioneve kabllore

Paketa më e varfër e një operatori kabllor është ajo e Tv Frahollit, që ofron për banorët e fshatit Çërravë në Korçë - vetëm 15 kanale. Ndërsa paketa më bujare është ajo e operatorit —Abom” që ofron plot 155 kanale televizive. Mesatarisht operatorët kabllorë ofrojnë nga 25 deri në 40 kanale televizive. Nga intervistat e kryera me disa prej administratorëve të televizioneve kabllore —jë familje është e interesuar për 10-12 kanale televizive”. Ndërkohë që ofrohet një paketë relativisht me 50 kanale, gjë që do të thotë se klientët gjenden përballë game të gjerë kanalesh televizive.

Autoriteti i Medias Audiovizive konstaton se pjesa më e madhe e rrjeteve kabllore mbështetet në teknologjinë e tejkualuar analoge, aplikimi i së cilës ka kosto të ulët dhe nuk kërkon kualifikim të lartë gjatë shfrytëzimit për një numër të vogël abonentësh.

Tabela 2

Teknologjia e marrjes së sinjalit	BE	Shqipëri
Nëpërmjet rrjeteve tokësore audiovizive	43	63.54
Nëpërmjet rrjeteve kabllore	30	22.54
Nëpërmjet rrjeteve satelitore	25	9.5
Nëpërmjet IPTV	7	4.42
Nëpërmjet internetit	4	-
Totali	109	100

Nga ana tjetër, këto sisteme mbartin shumë të meta, të cilat me rritjen e numrit të abonentëve bëhen pengesë për rritjen e mëtejshme të sasisë dhe cilësisë së shërbimeve.

Mungesa e sistemit të kontrollit të abonentëve, pengon ngritjen e një sistemi faturimi, duke e bërë të pamënaxhueshëm krejt sistemin. Kryerja e shërbimit në teknologjinë analoge e bën të vështirë, në mos të pamundur pasurimin e ofertës së kabllorëve më shërbime shtesë, si interneti apo telefonia.

Por, administratorët mendojnë ndryshe. Ata këmbëngulin se klientët e tyre nuk kanë dëshirë dhe mundësi që oferta të pasurohet me shërbime të tjera siç është shërbimi i internetit dhe shërbimi telefonik. Administratori i Tv kabllor Orikumi, Altin Shkurti thekson se vetëm abonentët sezonalë e kërkojnë internetin (gjatë verës shkon në 650-700 abonentë, ndërkohë në pjesën tjetër të vitit afërsisht 450 abonentë; në Orikum janë afërsisht 600 familje). Pjesa tjetër e marrin si shërbim nga kompanitë celulare. Të njejtën gjë pohon edhe administratoti i TV kabllor Dibra, Hajri Hoxha, i cili thekson faktin se pjesa më e madhe e abonentëve e sigurojnë internetin kryesisht nga kompanitë celulare. Pjesa dërrmuese e rreth 1000 abonentëve të TV kabllor Dibra preferojnë vetëm paketën televizive. Edhe administratori i Tv kabllor Cakranit (4 fshatra midis Vlorës dhe Fierit), Rustem Xhelaj, pohon të njejtën gjë. Abonentët janë më shumë të interesuar për paketën televizive dhe preferenca e tyre është kryesisht për kanalet informative.

Operatori —AËom”, ofron mundësi zgjedhjeve për klientët e tij. Me ofertën 3 në 1, pra në kabllin që ai sjell në familje ofron televizionin, telefoninë fikse dhe internetin (30 % e abonentëve me tre shërbimet, 40 % televizionin dhe 30 % internetin). Në lidhje me internetin Tirana ka përqindjen më të lartë të kërkesës - 2 fish më shumë sesa rrethet. Kjo kompani në ndryshim nga pjesa tjetër e Tv

kabllorëve ABCom ofron alternativë platformash me paketa të ndryshme televizive - familjare dhe për biznese. ABCom ka një rrjet të mirë strukturuar shërbimesh në Shqipëri. Ajo që vlen të theksohet investimi në vit shkon rreth 10 milion lekë, Pikat e shitjes ABCom shtrihen në 6 qytete: Tiranë, Vlorë, Shkodër, Lushnje, Durrës, Elbasan, Fier dhe Pogradec. Një pjesë e rrjetit të ofruar është me fibër, tjetra me bashkëpunim vendor - marrje me qira, pasi në zonat ndërrurbane. Ka alternativë në ofrimin e rrjeteve interurbane.

Punësimi në TV kabllorë

Kryesisht operatorët kabllorë janë biznese familjare, ku janë të punësuar nga 1 deri në 3 persona (administratorët e intervistuar kishin të paktën 4 të punësuar). Sipas statistikave zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive, vetëm 55 nga 115 operatorë të licensuar kanë deklaruar se kanë punonjës të punësuar me kohë të plotë. Ndërsa 16 nga këta 55 kanë deklaruar edhe punonjës me kohë të pjesshme. Të gjendur përballë këtij fakti, Autoriteti i Mediave Audiovizive e vuri si një kriter në rregulloren për licensimin ose rilicensimin e këtyre operatorëve, punësimin e të paktën 3 personave. Por, ky kriter është kundërshtuar nga operatorët si i pamundur për t'u realizuar. Përjashtim bën ABCom si kompani me 430 të punësuar në gjithë vendin.

Në lidhje me konkurrencën e OMSHA theksi bie tek cilësia e shërbimit që përdor operatori, dhe cilësia e suportit. Vlen të theksohet se ABCom investimin e ka pasur rreth 30-40 milion euro dhe strategjia e saj është shtrirja në zonat urbane e ndërrurbane.

Interesant është fakti sesi shihet nga OMSHA procesi i dixhitalizimit dhe strategjitë që do përdorin për mbijetesën në treg. Ajo që duhet theksuar është se një pjesë e OMSHA janë konfuzë për c'ka do ndodhë pas këtij procesi (administrator i Best Cable), ndërkohë që një pjesë tjetër theksojnë se përkundrazi procesi i dixhitalizimit mund të mbështetet te OMSHA (administrator ABCom, TV kabllor Fieri, Tv kabllor Dibra). Megjithatë patjetër që procesi i dixhitalizimit do të prekë edhe OMSHA, por presupozohet që do të gjendet zgjidhja e frekuencave dhe përfshirjes së operatorëve kabllorë në to. Nga ana tjetër operatorët kabllorë kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në transmetimin e qasjen e përmbajtjes televizive në

pothuaj gjithë vendin, duke aksesuar edhe audiencat më të largëta në rajonet më të paaksesueshme. Aq më tepër që mendojmë se do t'i vijë në ndihmë edhe procesit të dixhitalizimit. Frekuencat e dhëna për vendin tonë padyshim që do mbulojnë kërkesën më të madhe për aksesim, por në rajone të ndryshme, aksesimi i audiencës mund të vijë nëpërmjet OMSHA.

Në fund mund të themi se:

Në Republikën e Shqipërisë Operatorë të Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA, emërtimi ligjor) që ofrojnë përsëritjen e sinjalit televiziv nëpërmjet kabllit funksionojnë kryesisht në zonat rurale ose qytezat me një nivel shumë të ulët ekonomik.

Operatorë kabllorë garantojnë sinjalin TV të disa dhjetra kanaleve televizive (televizione lokalë vendas, televizionet kombëtare, TVSH, televizionet informative ose televizione të huaja) në zona, ku nuk është i mundur mbulimi televiziv analog, edhe nga operatorët televizivë kombëtarë.

Operatorët kabllorë operojnë me kabëll dhe një pjesë me fibra optikë.

Pjesa domethënëse e operatorëve kabllorëve janë biznese familjare, kjo duket edhe nga numri i të punësuarve, 1 deri në 3 ose 4 të punësuar.

Oferta e OSHMA-ve në fushën e shërbimit kabllor është më e madhe se kërkesa, qoftë në shërbime, qoftë në numrin e televizioneve që garanton.

Konsumatori është shumë i interesuar kryesisht që në paketat e ofruara të jenë kryesisht televizionet gjeneraliste, ato informative si dhe televizionet lokale.

Çmimet për “paketën” që ofrohet nga operatorët kabllorë shkojnë 500-600-700 lekë në muaj. Çmimet në të shumtën e rasteve vendosen nga administratorët, të cilët në zona të ndryshme operojnë me shifra të diktuar edhe nga tregu konkurrencial (rastet kur në një zonë operojnë 3-4 ose më shumë operatorë kabllorë). Pra, nuk ka transparencë çmimesh. Por, ka edhe operatorë si ABCom i cili i ka çmimet të deklaruara përkrah paketës së ofruar (familjare, biznes, po ose një nga paketa 3 në 1). Në dallim nga pjesa tjetër ABCom ofron pagesën online.